

INFORMATA PËR VIZË EMIGRUESE NËPËRMJET TË PROGRAMIT LOTARIA 2006

Programa e lotarisë emigruese DV-2006 mundëson fitimin e vizave për qëndrim të përhershëm për personat që i plotësojnë kushtet e thjeshta por rigoroze. Vizat janë të shpërndara nëpër 6 rajone gjeografike, numri më i madh i vizave ju takon vendeve të cilat kanë përqindje më të ulët të emigrimit dhe do të ju pamundësohet vendeve të cilat për pesë vitet e fundit kanë dërguar më tepër se 50000 emigrues. Në kuadër të një rajoni një shtet nuk mund të fiton më tepër se 7 përqind nga numri i përgjithshëm i vizave të parapara për atë vit

Parashtrimi i kërkesave të cilat do të pranohen nga shtetasit e shteteve në vijim nuk do të shqyrtohen sepse ata kanë dërguar më tepër se 50 000 emigrues në SHBA për një vit në pesë vitet e fundit. Kanada, Kina, Kolumbia, Republika Dominikane, El Salvadori, Haiti, India, Jamajka, Meksika, Pakistani, Filipinet, Rusia, Korea e Jugut, Britania e Madhe (me përjashtim Irlandë e Veriut) dhe teritoret tjera të varura, edhe Vietnamit. Kërkesat e atyre të cilët janë të lindur në Hong Kong, Makao dhe Tajvan do të shqyrtohen.

Kërkesat për programën DV-2006 patjetër duhet të parashtrihen nëpërmjet postës elektronike dhe duhet të arrijnë mbrenda këtij afati: e premte 5 nëntor 2004 dhe e premte 7 janarë 2005. Formularet mund që t'i merrni nga faqja elektronike në www.dvlottery.state.gov në afat prej 60 ditëve duke filluar nga 5 nëntori. Kërkesat e parashtruara nëpërmjet postës së rëndomtë nuk do të merren parasysh.

KËRKESAT PËR LUTJE

Parashtruesit e kërkesës patjetër duhet të jenë qytetarë të një prej shteteve të numëruara në faqen 10. Shiko listën e shteteve qytetarët e të cilëve mund të kualifikohen sipas rajoneve?

Vendasit e shteteve të cilët mund të kualifikohen: Në të shumtën e rasteve kjo do të thotë shteti ku ju keni lindur.

Mirëpo, nëse aplikuesi është i lindur në njërin prej shteteve të cilat nuk kualifikohen për marrjen e vizës por bashkëshorti/bashkëshortja është i/e lindur në shtetin i cili është në listën e shteteve të kualifikuara për marrjen e vizës, aplikuesit e tillë mund të paraqesin shtetin e bashkëshortit/bashkëshortes dhe të dy mund të marrin vizë dhe të hyjnë në të njëjtën kohë në SHBA. Nëse aplikuesi është i lindur në shtetin i cili nuk është në listën e shteteve të kualifikuara, dhe asnjëri nga prindërit nuk ka lindur ose jetuar atje në kohën kur aplikuesi ka lindur, aplikuesit e tillë mund të paraqesin vendin e lindjes të njërit nga prindërit.

Aplikuesit patjetër duhet të kenë të kryer shkollën e mesme ose aftësi pune të mjaftueshme sipas kërkesave të DV programës për vizë.

Shkollimi ose aftësi pune: Aplikuesi patjetër duhet të ketë shkollën e mesme të kryer ose diçka të ngjajshme, e përcaktuar si 12 vjet shkollim të kryer, shkollën fillore dhe të mesme, ose dy vjet përvojë pune në pesë vitet e kaluara në profesion i cili kërkon më së paku dy vjet trajnim ose experiencë. Departamenti i SHBA-ve sektori për punësim nëpërmjet faqes së internetit do të vendos për kualifikimin e përvojës së punës. Aplikuesit gjithashtu do të mund t'a gjejnë listën e profesioneve të kualifikuara në web faqen konsullore: www.travel.state.gov

PROCEDURA PËR PARASHTRIMIN E KËRKESËS PËR PROGRAMI LOTARIA 2006

- **Të gjitha kërkesat e parashtruara do të diskualifikohen nëse janë të pranuar më tepër se një herë, pa marrë parasysh se nga kush është bërë kërkesa.**
- **Stejt Departamenti do t'i pranon vetëm kërkesat e plotësuara elektronike në www.dvlottery.state.gov duke filluar nga 5 nëntori 2004 deri ne 7 janare 2005.**
- **Stejt Departamenti do të dërgon konfirmim elektronik për të gjitha kërkesat e pranuar, (EDV aplikacionet).**
- **Kërkesat e parashtruara nëpërmjet postës së rëndomtë nuk do të pranohen.**
- **Kërkesat e parashtruara do të refuzohen nëse nuk janë të dorëzuara të gjitha fotografitë e kërkuara.** Fotografi për aplikantin, për bashkëshortin /bashkëshorten, fëmijët të moshës ndër 21 vjeç, duke i përfshirë të gjithë fëmijët gjenetikiisht të juaj, gjithashtu edhe fëmijët e adoptuar në mënyrë ligjore, fëmijët nga martesat tjera, përjashtim bëjnë vetëm fëmijët të cilët kanë nënshtetësi amerikane ose posedojnë status legal të qytetarit të përhershëm, duhet të përfshihen në aplikacionin tuaj edhe fëmijët të cilët nuk jetojnë më me ju edhe ata të cilët nuk dëshirojnë të emigrojnë me ju nëpërmjet programës së lotarisë 2005. Fotografi familjare dhe në grupe nuk do të pranohen, patjetër duhet të dorëzoni fotografi të veçantë për secilin anëtarë të familjes.

Secili aplikues, bashkëshort/bashkëshorte dhe secili fëmij duhet të dorëzon fotografi digjitale e cila duhet t'i bashkangjitet kërkesës në mënyrë elektronike. Fotografia mund të realizohet ose me fotoaparatur digjital ose duke e skenuar fotografinë e realizuar me skaner digjital.

Nëse fotografia e dorëzuar nuk i përmbush kërkesat e poshëtshënuara, kërkesa juaj për emigrim nëpërmjet programës së lotarisë 2006 do të refuzohet për çka ju edhe do të informoheni.

- Fotografia patjetër duhet të jetë e realizuar në format Joint Photographic Experts Group (JPEG).
- Fotografia duhet të jetë ose me ngjyra ose bardhë e zi; monokromë fotografitë nuk do të pranohen.
- Nëse keni fotografi të re digjitale ajo duhet patjetër të ketë dallueshmëri prej 320 piksela gjërësi dhe 240 piksela gjatësi, dhe 24 bit thellësi të ngjyrës, 8 bit me ngjyrë ose 8 bit bardhë e zi (ngjyrë hiri).
- Nëse fotografia është e skanuar, atëherë fotografia e shtypur duhet të jetë 50 mm x 50 mm. Patjetër duhet të ketë dallueshmëri prej 150 pika për inç dhe me thellësi ngjyre prej 24 bit ngjyrë, ose 8 bit me ngjyre ose 8 bit bardhë e zi, (ngjyrë hiri)
- Madhësia maksimale e fotografisë që do të pranohet do të jetë 62 500 byte.

Nëse fotografia e dorëzuar nuk i plotëson specifikacionet e poshtshënuara kërkesa juaj do të refuzohet

- Parashtruesi i kërkesës, bashkëshorti/bashkëshortja ose fëmijët duhet të shikojnë drejt në objektivin e fotoapararit, koka nuk duhet të shikoj lartë, as poshtë, as anësh dhe duhet të mbuloj afër 50 % të fotografisë.
- Fotografia duhet të realizohet me prapaskenë neutrale ose me ngjyrë shumë të lehtë. Fotografitë e realizuara me prapaskenë të errët ose jo të qartë nuk do të pranohen.
- Fotografitë ku fytyra e personit nuk shikon në fokus të objektivit nuk do të pranohen.
- Fotografitë ku aplikuesi mban syze ose gjëra tjera të cilat reflektojnë dritën nuk do të pranohen.
- Fotografitë ku aplikuesi mban kapele ose shamijë me karakter religjioz do të pranohet, por edhe atëherë nuk duhet të mbulohet fytyra e aplikuesit. Fotografitë ku aplikuesi mban kapele ose diçka tjetër në kokë që nuk ka karakter religjioz nuk do të pranohet. Fotografitë ku aplikuesi ka kapele të ushtrisë, ose aviacionit nuk do të pranohet.

LUTJA

Egziston vetëm një mënyrë e parashtrimit të kërkesës për DV-2005. Aplikuesi patjetër duhet të mbush lutjen në mënyrë elektronike në www.dvlottery.state.gov Plotësimi gabimisht i lutjes do të refuzon kërkesën tuaj. Aplikuesi duhet t'i shënon në aplikacionin e tij EDV informatat që vijojnë:

1. **Emrin e saktë** – mbiemrin, emrin, emër të dytë (nëse keni).
2. **Ditëlindja** – dita, muaji, viti.
3. **Gjinia** – mashkull, femër.
4. **Qyteti/vendi i lindjes.**
5. **Shteti i lindjes** – emri i shtetit duhet të jetë vendi ku aplikuesi është i lindur.
6. **Fotografi për aplikuesin** – shif faqen 2 për specifikacionet e fotografisë.
7. **Adresa postale** – adresa, vendi, lagja, qyteti, shteti, numri postal

8. **Numri i telefonit**
9. **E-mail adresa (adresa elektronike)**
10. **Emri i shteti tjetër nëse shteti i lindjes është i ndryshëm nga shteti ku tashti jeton aplikuesi** – nëse aplikuesi paraqet shtet tjetër i cili është i ndryshëm nga shteti ku ai jeton, kjo informatë patjetër duhet të shënohet në formular. Nëse aplikuesi paraqet nënshtetësinë e tij nëpërmjet burrit/grues së tij atëherë atë informatë duhet ta shënon në formular.
11. **Statusi social** – i/e martuar, i/e shkurorëzuar, i/e ve Po ose Jo.
12. **Numri i fëmijve të cilët janë të pamartuar dhe të cilët janë të moshës ndër 21 vjeç**
13. **Informacione për bashkëshorten/bashkëshortin** – emri, ditëlindja, gjinia, vendi, qyteti i lindjes, shteti i lindjes, fotografia.
14. **Informacione për fëmijë-** emri, ditëlindja, gjinia, vendi, qyteti i lindjes, shteti i lindjes, fotografia.

Vini re: aplikacioni patjetër duhet të përmbajë: emrin, ditëlindjen, vendlindjen e aplikuesit, bashkëshortit/bashkëshortes, fëmijët e juaj të lindur, fëmijët e adoptuar në mënyrë ligjore, fëmijët nga martesat tjera, të cilët nuk janë të martuar dhe nuk janë më të moshuar se 21 vjeç, përjashtimë bëjnë vetëm fëmijët të cilët janë shtetas të SHBA-ve ose kanë qëndrim të përhershëm legal në SHBA, edhe nëse ju nuk jeni ende i/e martuar me prindërin e fëmiut, edhe nëse prindi i fëmiut nuk jeton më me ju ose nuk dëshiron të emigron me ju. Vini re se fëmijët të moshës 21 vjeç dhe më të vjetër, dhe të martuar nuk do të kualifikohen për këtë lloj vize. Mos evidentimi i të gjithë fëmijve tuaj do të ndikon në refuzimin e aplikacionit tuaj.

ZGJEDHJA E APLIKANTËVE

Aplikuesit do të zgjedhen me tërheqje prej kompjuterit nga të gjitha kërkesat e suksesshme. Ata të cilët do të zgjedhen do të informohen më postë gjatë muajit maj dhe korrik 2005, gjithashtu do të informohen për udhëzimet e mëtutjeshme, dhe për taksat e parapara për emigrim në SHBA. **Aplikuesit të cilët nuk do të zgjedhen nuk do të pranojnë kumtim.** Ambasadat dhe konsulatat amerikane nuk do të mund të kumtojnë listën e aplikuesve të suksesshëm. Bashkëshortët dhe fëmijët e pa martuar të moshës ndër 21 vjeç mundet gjithashtu të kërkojnë t'u bashkangjiten aplikuesve të suksesshëm. Vizat për DV-2006 do të jepen ndërmjet 1 tetorit 2005 dhe 30 shtatorit 2006.

Për të marrë vizë, aplikuesit e zgjedhur duhet patjetër t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara sipas ligjit të SHBA-ve. Shqyrtimi i kërkesave të suksesshme dhe dhënien e vizave aplikuesve të suksesshëm dhe për të afërmit e tyre duhet PATJETËR të bëhet deri në mesnatën e 30 shtatorit të vitit 2006. Në kurfarrë rrethanash DV vizat nuk mund të jepen pas kësaj date, as nuk mund të aprovohet asnjë rregullim, dhe asnjë anëtar i familjes nuk mund t'i bashkangjitet aplikuesit pas kësaj date për të emigruar në SHBA.

Njoftim i rëndësishëm

Nuk ka nevojë të paguhet për lutje për programën DV. Qeveria amerikane nuk punëson konsultant të jashtëm për shërbime private që t'u shërbejnë aplikuesve për DV vizën. Nëse ndonjë ndërmjetsues ju ofron shërbime për përgatitjen e kërkesës tuaj për DV vizën atë e bën pa autorizimin dhe pa lejen e qeverisë amerikane. Shfrytëzimi i shërbimeve të jashtme nga konsultantë të jashtëm është në përgjegjësinë tuaj.

Kërkesa e dorëzuar drejtpërsëdrejti nëpërmjet postës elektronike ka mundësi që e njëjta të kualifikohet nga qendra konsullore në Kentaki, gjithashtu si një kërkesë e cila është e përgatitur nga konsultantë të jashtëm. Çdo kërkesë e pranuar gjatë kohës së pranimi të kërkesave për DV vizat do të ketë mundësi të barabarta të zgjedhet. Por, nëse një kërkesë e njëjtë është e pranuar më tepër se një herë pa marrë parasyshë se prej nga është e parashtruar ajo do të refuzohet.